

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autorteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot.	2024/ZDP/181		
Br. prot./Prot.Nr.	Kopje:	Datë: 12 / 06 / 2024	
Stranice/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Prisina/Prisina	
Dalës/izlazno/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/interna/intemat	<input type="checkbox"/>		

PLANI I INTEGRITETIT 2024 – 2026

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Përmbajtja

Deklarata e Integritetit	3
Hyrje	4
Përmbajtja e Planit të Integritetit.....	5
Qëllimet e Planit të Integritetit	5
Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	6
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	6
Metoda e vlerësimit të rrezikut	7
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	8
Monitorimi i Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Raportimi	8
Fushat e rrezikut.....	9
Fushat e përgjithshme të rrezikut	9
Fushat specifike të rrezikut.....	9
Shtojcë:	16
Pyetësor për Planin e Integritetit.....	16

Deklarata e Integritetit

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) është agjenci rregullatore përgjegjëse për rregullimin e sigurisë në aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura.

AAC është organizatë me të hyra buxhetore dhe autoritet publik dhe iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC ka përgatitur Planin e Integritetit në pajtim me Nenin 25 Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe me Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të miratuar me datë 26.07.2023 nga Agjencia per Parandalim të Korrupsionit.

Me Plan të Integritetit, AAC përmes mekanizmave ligjor do të zbatojë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet dhe objektivat në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Me identifikimin e rreziqeve si dhe planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe eliminojmë shkaqet e korrupsionit dhe sjellëve tjera që cenojnë integritetin e institucionit.

Ne jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e riskut ndaj integritetit në kulturë organizative në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në Autoritetit të Aviacionit Civil. Kjo deklaratë ka për qëllim pasqyrimin e politikave, procedurave dhe masave tjera përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien në Autoritetin e Aviacionit Civil . Deklarata mbështetet në Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin Nr.03/L-051 të Autoritetit të Aviacionit Civil, të ndryshuar dhe “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” përgatitur nga Agjencioni për Parandalim të Korrupsionit.

Andaj, ne besojmë që ky Plan i Integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën Kundër Korrupsionit, dhe zotohemi për përkushtimin e duhur për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit në AAC.

Burim DINARAMA
U.D. Drejtor i Autoritetit të Aviacionit Civil



Hyrje

Në pajtim me nenin 25 të Ligjit Nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me Metodologjinë Uniforme të miratuar me datën 26.07.2023 nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me anë të cilave obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Autoriteti i Aviacionit Civil ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit sipas ndryshimeve që mund të pësojnë si nga aspekti financiar apo rrethana tjera.

Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Autoritetit të Aviacionit Civil dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Plani rritetson përkushtimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe forcimin dhe sundimin e ligjit, po ashtu vlerat dhe standardet profesionale.

Përmbajta e Planit të Integriteti

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejt i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, Plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Plani i integritetit mundëson:

- ✓ Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në AAC;
- ✓ Vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë dhe
- ✓ Evidentimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale;

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Autoritetit të Aviacionit Civil. I gjithë stafi ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

Qëllimet e Planit të Integritet

- ✓ Sistemi efektiv i menaxhimit të integritetit në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- ✓ Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- ✓ Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- ✓ Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në Autoritetit të Aviacionit Civil.

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit të Autoritetit të Aviacionit Civil është zhvilluar sipas fazave të përcaktuara në Metodologjinë e planit të integritetit të përgatitur nga Agjencia për parandalim të korrupsionit.

Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Faza e parë: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil përmes vendimit nr. 82/2023 të datës 06.12.2024 ka caktuar grupin punues dhe koordinatorin për hartimit e planit të integritetit të AAC-së. Grupi Punues pas emërimit ka bërë takimin e parë të punës më datë 10.01.2024 dhe ka njoftuar punonjësit për Planin e Integritetit me qëllim që të mund të bëjnë mbledhjen e informacioneve të nevojshme për hartimin e këtij plani. Grupi punues ka shqyrtuar kornizën ligjore (rregulloret, planet, auditimin e brendshëm, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

Faza e dytë: Grupi punues ka hartuar pyetësonin sipas specifikave të AAC dhe ka dërguar te i gjithë stafi, si dhe ka realizuar intervista përmes pyetësonit me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit me punonjës të Autoritetit të Aviacionit Civil. Mbi bazën e rezultatit të pyetësonit, përcaktohen fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve. Grupi punues për të gjitha takimet e mbajtura ka regjistruar procesverbalin me komentet dhe diskutimet të cilat janë dhënë nga anëtarët e grupit punues.

Faza e tretë: Grupi Punues përmes të dhënave të siguruara nga shqyrtimi i dokumenteve dhe të dhënave nga pyetësoni ka hartuar një listë të rreziqeve që mund të cenojnë veprimtarinë e Institucionit dhe ka propozuar masat për përmirësim. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil miraton planin e integritetit dhe masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tri (3) vjeçare. Plani i miratuar do të publikohet në faqen zyrtare të AAC.

Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etikë.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10																			
		9																			
		8																			
	Mesatar	7																			
		6																			
		5																			
		4																			
	Vogël	3																			
		2																			
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10										
Intensiteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar				Lartë												
		Probabiliteti/Gjasat																			

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Monitorimi i Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda Autoritetit të Aviacionit Civil dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integritetit është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara që janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e Planit të Integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda Autoritetit të Aviacionit Civil, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Fushat specifike të rrezikut

Pyetësi në kuadër të zhvillimit të Planit të Integritetit, Autoritetit të Aviacionit Civil ka krijuar pyetësin Online, ku kanë marr pjesë 15 pjesëmarrës, punonjës të AAC, ku janë përfshirë kryesisht anëtarët e Grupit Punues dhe përgjegjës të njësive. Të dhënat e marra nga pyetësi janë pasqyruar kryesisht edhe në Fushat e Përgjithshme të Rrezikut dhe Fushat e Veçanta të rrezikut. Në kuadër të Planit të Integritetit, ku janë paraqitur në formën tabelave fushat e rrezikut të ndarë në dy pjesë, në formën diagonale është bashkëngjitur edhe pyetësi me përqindje të rezultateve të fituara nga secila pyetje.

Lista e përbërjes së Grupit Punues për Hartimin e Planit për Integritet:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Njësia
Grupi Punues		
1	Minir Istrefi	Kryesues
2	Safete Selmani	Koordinator /Anëtar
3	Alban Thaçi	Anëtar
4	Sala Ahmeti	Anëtar
5	Granit Berisha	Anëtar
6	Albulena Gerxhaliu	Anëtar

Person përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit për Autoritetin e Aviacionit Civil është emëruar:

Znj. Safete Selmani, Njësia e Burimeve Njerëzore në AAC.

Planit i Integritetit						
Fushat e përgjithshme të rrezikut						
Fusha e rrezikut	Identifikimi i Rrezikut			Masat ndaj rrezikut		
	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Intensiteti i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
			Gjasat	Vlerësimi i rrezikut		
Drejtimi dhe Menaxhimi i AAC-së	Mungesa e personelit në fusha të ndryshme të AAC-së.	Ligjet janë pjesërisht të mjaftueshme aktet nënligjore dhe procedura që përshkruajnë proceset hap pas hapi.	5	35	Rekrutimi i stafit (personel shtesë në AAC).	Bazuar në rishikim të buxhetit
	Kryerja e detyrave shtesë të cilat nuk janë në përshkrimin e detyrave të punës.	Shumica e stafit të AAC-së kryejnë detyra shtesë si punë dytësore me vendime të DP.	5	40	Rekrutimi i stafit (personel shtesë në njësitë përkatës për të mbuluar punët që janë dytësore në AAC).	ZDP
	Veprimet për të korrigjuar gjetjet nga Auditimet.	Kryhen veprimet sipas rekomandimeve për të korrigjuar gjetjet e auditorëve, por jo mjaftueshëm ju përmbahemi afateve.	3	18	ZDP dhe menaxhmenti i AAC-së duhet të obligojnë stafin përgjegjës për respektimin e afateve nga gjetjet e auditorit.	Janar-Dhjetor 2024

	Mekanizëm që informacioni i sigurisë së aviacionit mbahet konfidencial.	Nuk kemi ndonjë mekanizëm që informacioni i sigurisë së aviacionit mbahet konfidencial.	20	35	55	Grupi punues propozon të ketë një mekanizëm për këtë çështje.	ZDP të caktoj një grup punues.	Gjatë vitit 2025
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
	Identifikimi i Rrezikut	Intensitetit i rrezikut	Masat ndaj rrezikut					
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Politika e Burimeve Njerëzore, Sjellja Etike dhe Profesionale të Punësuarve	Respektimi i procedurave dhe rregullave të punës nga gjithë stafi duke përfshirë mbikëqyrësit.	Udhëheqësit e Njësive përgjegjëse.	5	6	30	AAC të nxjerr një kod të etikës në nivel të institucionit.	ZDP të caktoj një grup punues.	Dhjetor 2024
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
	Identifikimi i Rrezikut	Intensitetit i rrezikut	Masat ndaj rrezikut					

Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Mungesa e buxhetit nga Ministria e Financave, në realizimin e planit të përgjithshëm të AAC-së	Ligjet dhe aktet nënligjore.	7	8	56	Arsyetimi me i qartë për buxhet shtesë.	ZDP, ZKF	Qershor-Dhjetor 2024
	Ndikimi i vendimmarrjes nga niveli qendror (Ministria e Financave) në AAC në zvogëlimin e efikasitetit në punët e Agjencisë.	Ligjet, aktet nënligjorë dhe aktet e brendshme.	3	6	18	Intensifikimi i takimeve për koordinim në vendimmarrje mes të dy niveleve me argumente të arsyeshme për të mbuluar nevojat sipas akteve të zbatueshme në AAC.	ZDP, ZKF	Janar-Dhjetor 2024
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Identifikimi i Rrezikut					Intensiteti i rrezikut	Masat ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit


Ruajtja dhe Siguria e të Dhënave dhe Dokumenteve	Rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT-së, funksionimi i ueb faqes zyrtare.	Udhëzimet administrative në fuqi.	7	8	56	Rekrutimi i një zyrtari të IT-së, që të bëjë komunikimin e vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare të AAC-së.	ZDP	Bazuar në rishikim të buxhetit për 2025
Prokurimi Publik	Menaxhimi i Projekteve/Kontratave	Ligji i Prokurimit Publik dhe aktet nënligjore.	2	5	10	Të bëhet kërkesë për trajnim të stafit që caktohen në Komisionet për përpilimin e specifikacioneve teknike dhe menaxhimin e kontratave.	KRPP, IKAP.	Janar-Dhjetor 2024
Fushat specifike (veçanta) të rrezikut								
Identifikimi i Rrezikut			Intensitetit i rrezikut			Masat ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat		Vlerësimi i rrezikut		Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati

Sistemi i menaxhimit	Rregulloret, manuallet, proceset, procedurat të pa përditësuara.	Procedura për rishikimin vjetor të dokumentacionit.	3	9	27	Plani për implementimin e sistemit të menaxhimit dhe Auditimi i brendshëm.	ZDP	Maj-Dhjetor 2024
----------------------	--	---	---	---	----	--	-----	------------------

Shtojcë:


Pyetësor për Planin e Integritetit

Sa është numri i stafit që ju menaxhoni?
15 responses




Përvoja juaj e punës në sektorin publik?

15 responses




A ka respektim të procedurave, rregullave të punës nga i gjithë stafi duke përfshirë edhe mbikëqyrësit?

15 responses




Sipas mendimit tuaj, a ka fusha funksionale në departamentin/njësinë tuaj ku nuk dihet mirë se kush është përgjegjës për detyra të caktuar dhe ka dyfishim të përgjegjësiave që pengon llogaridhënien?

15 responses




A mendoni se funksionet/proceset janë të mbuluara me rregullore, procedura të qarta që përshkruajnë proceset hap pas hapi?

15 responses




Sa i përket përshkrimit të detyrave të punës, a janë të qarta dhe a japin pasqyrë të detajuar lidhur me kompetencat të cilat ju duhet ti keni në lidhje me përgjegjësitë dhe linjën e raportimit?

15 responses




A mendoni se duhet të kryeni detyra të cilat nuk janë në përshkrimin e detyrave tuaja të punës?

15 responses




A medoni se është i drejtë niveli i shërbimit duke përfshirë pagat dhe përfitimet?

15 responses




Deri në çfarë mase mendoni se është i përkushtuar menaxhmenti për një sistem të fortë të kontrollit të brendshëm?

15 responses




A i është nënshtruar puna juaj ndonjë auditimi nga ana e Institucioneve vendore apo ndërkombëtare gjatë dy viteve të fundit.

15 responses




A mendoni se ndërmirren veprime për të korrigjuar gjetjet nga auditimet

15 responses



A ka ndonjë mekanizëm në institucionin tuaj për ankesa sa i përket shkeljes së integritetit?


15 responses



- Po
- Pjesërisht
- Jo
- Ka komision Disiplinor në nivel të organizatës
- Po kerkoni me plotesu pytesorin, e askush nuk na ka spjegu cka dmth "shkejja e integritetit"!!!

A ka ndonjë kod të etikës që zbatohet në AAC?

15 responses



- Po
- Pjesërisht
- Jo
- Nuk kam njohuri
- Kodi i etikës per Sherbysit civil nuk jam ne dijeni
- Nese eshte pyetja "a ka kod te etikës", pergjigja eshte "Nuk e di"! Prandaj nuk e di a zbatohet!
- Nuk e di

A organizohen mbledhje në mes të menaxhementit dhe personelit lidhur me paraqitjen, diskutimin e qëllimeve dhe prioriteteve strategjike kundër korrupsionit?

15 responses




A jeni ballafaquar ndonjëherë në ndonjë situatë të konfliktit të interesit?

15 responses




A mendoni se AAC ofron të dhëna të mjaftueshme, të sakta, të qasshme dhe lehtë të përdorshme për palët e interesit në faqe të internetit?

15 responses




A mendoni se ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të TI. (p.sh. ndryshimet e fjalëkalimeve, hyrje e kufizuar në të dhënat TI, etj.)?


15 responses



A ka procedurë për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin/ digjitalizimin e dokumentacionit?
15 responses




A janë të qasshme dokumentet publike të AAC-së?
15 responses



A mendoni se auditimi i brendshëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë ndikon në përmisimin e proceseve të punës?
15 responses




A mendoni se mbikëqyrja e rregullt e operatorëve nga AAC-ja ndikon në zhvillimin dhe mbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë?
15 responses



A mendoni se lëshimi e licencave, certifikatave dhe lejeve bëhet në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së?
15 responses




A jane te mjaftueshme dhe transparente dhe transparente, planet e trajnimeve profesionale, grantet nga IPA .TAIEX,ENAC, etj.
15 responses



A mendoni se mungesa ose mos harmonizimi i akteve nënligjore/Rregulloreve/udhëzimeve ndikon në funksionimin dhe sigurinë e Aviacionit?


15 responses



- Po
- Pjesërisht
- Jo
- Ne fushen time nuk ka mungese apo mos harmonizim te akteve nenligjore.... pyetja e pa kjarhte.
- Aktet nenligjore behen oer favorizimi sig eshte rregullorja per kredencialet e ins...
- Duhet te harmonizohen, sipas ligjeve ne fuqi

A mendoni se duhet të bëhet një analizë e përgjithshme dhe të nxirren rekomandime në nivel të AAC-së pas hetimit të raporteve të ndodhjeve në AAC?

15 responses



- Po
- Pjesërisht
- Jo
- Me vjen keq që nuk e keni lexuar Rregulloren për raportimin e ndodhjeve para se me be kete pyetje!


A mendoni se cenohet autoriteti i AAC-ë nga bashkëpunimi jo i mirë me operatorët?

15 responses



A mendoni se mungesa e buxhetit të ndarë nga MF, ka ndikuar në realizimin e planit të përgjithshëm të AAC-së.

15 responses



A mendoni që duhet të prezantohet certifikata mjekësore për nëpunësit e AAC-së ?


15 responses



- Po
- E domosdoshme
- Jo
- HAAAAHA dy zgjidhje per pergjigje pozitive! Cfare nenkuptohet me certifikaten mjekesore? Cilat egzaminime duhe te perfshihen? Cfar do pergjigje te jepi, duhet me dite qe nje kerkese e tille eshte JOLIGJORE!!! Mendoj qe ne AAC ka me shume nev...

A mendoni që është e nevojshme certifikata e sigurisë për nëpunësit e AAC-së?


15 responses



- Po
- E domosdoshme
- Jo
- Vetëm në raste të menaxhmentit të lartë të organizatës
- Pyetja është e pa qartë
- Cka eshte kjo?

A ka AAC mekanizëm që informacioni i sigurisë së aviacionit mbahet konfidencial dhe nuk mund të rrjedhë në duart e palëve të paautorizuara?

15 responses



A ka siguruar AAC-ja një kulturë të sigurt të raportimit, duke minimizuar rreziqet e raportimit të padrejtë ose të mos raportimit të ngjarjeve të rrezikshme?

15 responses

